

20050620912

L I G J I
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE
INVALIDË

Neni 1

Në Ligjin për punësimin e personave invalidë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 44/2000 dhe 16/2004), në nenin 1 pas fjalëve: “cilësi të punëdhënësit”, shtohen fjalët: “në administratën shtetërore, në njësitë e vetadministrimit lokal, në ndërmarrjet publike, në institucionet, në agjencitë dhe në fondet e institucionet e tjera shtetërore.”

Neni 2

Në nenin 2 paragrafin 1, fjalët: ”personi me pengesa të lehta në zhvillimin psikik”, zëvendësohen me fjalët: “personi me pengesa në zhvillimin intelektual”, presja zëvendësohet me lidhëzën “dhe”, ndërsa fjalët: “edhe personi me psikoza” shlyhen.

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

“Person invalid konsiderohet edhe invalidi i punës me aftësi të ngecur ose të zvogëluar pune dhe nëse mbahet në evidencën e Agjencisë për punësim në Republikë e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) si person i papunësuar.”

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 3 pas fjalës “person” vihet presje dhe shtohen fjalët: “prindi ose tutori i tij”

Neni 3

Në titullin e Kapitullit II fjalët: “KUSHTET DHE PRIVILEGJET E VEÇANTA ” zëvendësohen me fjalët: “MASA PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE”

Neni 4

Në nenin 4 në fjalinë hyrëse fjalët: “Kushtet dhe privilegjet e veçanta” zëvendësohen me fjalët: “Masat për përmirësimin e kushteve”.

Alineja 1 ndryshon si vijon:

“- ndarja e mjeteve të pakthyeshme për punësimin e personit invalid të papunësuar për kohë të pacaktuar, adaptimi i vendit të punës në të cilin do të punojë personi invalid nëse kjo është e nevojshme dhe furnizimi me pajisje sipas kritereve dhe në mënyrë të përcaktuar nga ministri i Punës dhe i Politikës Sociale”.

Neni 5

Në nenin 4-a në paragrafin 1 pika fshihet dhe shtohen fjalët: “edhe nëse nuk ka vlerësim për aftësinë e punës nga komisioni nga neni 2 paragrafi 3 i këtij ligji se mund t’i kryejë punët në vendin përkatës të punës”.

Paragrafi 2 ndryshon si vijon:

“Personi invalid mund të jetë punëdhënës ose të kryejë punë të personit përgjegjës te punëdhënësi nëse merr mendim pozitiv nga komisioni nga neni 2 paragrafi 3 i këtij ligji.”.

Neni 6

Pas nenit 4 shtohet nen i ri 4-b, si vijon:

“Neni 4-b

Punëdhënësi obligohet që personit invalid të punësuar t’i paguajë rrogë sipas ligjit, marrëveshjes kolektive dhe marrëveshjes për punësim.

Rrogën nga paragrafi 1 i këtij neni punëdhënësi obligohet që personit të punësuar invalid t'ia paguajë në llogarinë rrjedhëse ose në librezën e kursimit, ndërsa pagën mund ta tërheqë vetë personi me invaliditet, çifti bashkëshortor, prindi i tij ose tutori i tij.”

Neni 7

Neni 6 ndryshon si vijon:

“Mjetet për përmirësimin e kushteve për punësim dhe për punë të personave invalidë, adaptimin e vendit të punës dhe blerjen e pajisjes, sigurohen nga Fondi i veçantë për përmirësimin e kushteve për punësim dhe për punë të personave invalidë (në tekstin e mëtejme: Fondi i veçantë).”

Neni 8

Në nenin 7 pas paragrafit 2, shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

“Buxheti i Republikës së Maqedonisë për dedikimet nga paragrafi 2 i këtij neni, mjetet i siguron më së shumti në lartësinë e kompensimeve të rrogës bazë nga dy rrogat neto mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë në muajin paraprak. Për dallimin nga neto rroga e cila e tejkalon këtë shumë, mjetet për kontribute i paguan punëdhënësi”.

Neni 9

Neni 9 ndryshon si vijon:

“Për shkak të punësimit të personave invalidë, themelohen shoqëritë mbrojtëse si shoqëri tregtare. Shoqëri mbrojtëse mund të themelohet nëse punëson së paku pesë persona për kohë të pacaktuar prej të cilëve së paku 40% janë persona invalidë nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, ku prej tyre së paku gjysma janë persona me invaliditet të vërtetuar sipas nenit 2 paragrafit 1 të këtij neni. Shoqëria mbrojtëse e re e themeluar është e obliguar që në periudhë prej 90 ditësh t'i punësojë të gjithë punëtorët, llogaritur nga dita e punësimit të parë të punëtorit për kohë të pacaktuar në shoqëri, në të kundërtën nuk e fiton statusin e shoqërisë mbrojtëse dhe në pesë vitet e ardhshme nuk mund të punojë si shoqëri mbrojtëse, në të cilin afat themeluesi ose anëtari i familjes më të ngushtë, nuk mund të themelojë shoqëri të re mbrojtëse.

Shoqëria mbrojtëse nëse nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni për periudhë prej 90 ditësh, nuk e humb statusin e shoqërisë mbrojtëse. Nëse shoqëria mbrojtëse më shumë se tri herë në dy vitet e njëpasnjëshme e zvogëlon përqindjen minimale të personave invalidë ose bie nën numrin minimal të punëtorëve të përgjithshëm të punësuar për kohë të pacaktuar, të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, e humb statusin e shoqërisë mbrojtëse dhe në pesë vitet e ardhshme nuk mund të punojë si shoqëri mbrojtëse, në të cilin afat themeluesi ose anëtari i familjes më të ngushtë nuk mund të themelojë shoqëri të re mbrojtëse.

Nëse shoqëria mbrojtëse mbi 90 ditë nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, e humb statusin e shoqërisë mbrojtëse dhe në tri vitet e ardhshme nuk mund të punojë si shoqëri mbrojtëse, në të cilin afat themeluesi ose anëtari i familjes më të ngushtë nuk mund të themelojë shoqëri të re mbrojtëse.”

Neni 10

Në nenin 10 paragrafi 1 pas fjalës ”persona” shtohen fjalët: “edhe invalidët e punës”.

Neni 11

Në nenin 12 paragrafët 2 dhe 4 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

Neni 12

Në nenin 12-a paragrafi 1 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Agjencia obligohet të mbajë evidencë të personave invalidë të papunësuar në Republikën e Maqedonisë.”

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 3 pika fshihet dhe shtohen fjalët: “dhe nëse ka vlerësim për aftësinë e punës se mundet t’i punojë punët në vendin përkatës të punës”.

Neni 13

Në nenin 13 pas fjalës “paragraf” numri “2” zëvendësohet me numrin: “3”

Neni 14

Në titullin e Kapitullit IV fjala ”SIGURIM”, zëvendësohet me fjalën “PËRMIRËSIM”.

Neni 15

Në nenin 15 paragrafi 1 ndryshon si vijon:

“Për shkak të financimit të punëve për përmirësimin e kushteve për punësim dhe punës të personave invalidë, adaptimin e vendit të punës dhe blerjen e pajisjes, 10% e mjeteve të përgjithshme të realizuara nga kontributi ekzistues për punësim ndahen në nënlogarinë e Agjencisë (Fondin e veçantë) më së voni deri më datën 30 të muajit, për muajin paraprak.”

Paragrafi 2 shlyhet.

Në paragrafët 3 dhe 4 që bëhen paragrafë 2 dhe 3 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”, ndërsa fjala “i obliguar” zëvendësohet me fjalën “e obliguar”.

Neni 16

Në nenin 16 paragrafin 1 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

Pas paragrafit 1 shtohen tre paragrafë të rinj 2, 3 dhe 4, si vijojnë:

“Personit juridik që nuk është shoqëri mbrojtëse, mund t’i ndahen mjete nga Fondi i veçantë për personin e ri invalid të punësuar nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji për kohë të pacaktuar dhe adaptimin e vendit të punës në të cilin do të punojë personi invalid.

Shoqërisë mbrojtëse, mund t’i ndahen mjete nga Fondi i veçantë për personin invalid të sapopunësuar nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji për kohë të pacaktuar, adaptimin e vendit të punës në të cilin punon personi invalid dhe blerjen e pajisjes.

Personit invalid nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji nëse kryen veprimtari në mënyrë të pavarur si tregtar individual, mund t’i ndahen mjete nga Fondi i veçantë për punësimin e tij për kohë të pacaktuar, adaptimin e vendit të punës në të cilin do të punojë dhe blerjen e pajisjes.”

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragraf 5 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

Në paragrafin 3 i cili bëhet paragraf 6 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

Në paragrafin 4 i cili bëhet paragraf 7 pas fjalës “pajisja” fshihen fjalët: “, mbarimin e ndërtimit dhe adaptimin e lokalit të punës” ndërsa fjalët: “krijimi i kushteve të veçanta” zëvendësohen me fjalët: “përmirësimi i kushteve”.

Neni 17

Në nenin 16-a paragrafi 1 pika 1 ndryshon si vijon:

“punësimi i personit invalid nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji për kohë të pacaktuar në lartësi prej 20 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak para punësimit, përkatësisht 40 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak para punësimit të personit plotësisht të verbër (personit praktikisht të verbër) dhe personit me invaliditet trupor të cilit për shkak të lëvizjes i duhet karrocë invalidësh;”.

Në pikën 2 fjalët: “30 rroga mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për muajin paraprak para paraqitjes së kërkesës” zëvendësohen me fjalët: “100 000 denarë”, ndërsa pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Pika 3 ndryshon si vijon:

“blerjen e pajisjes në lartësi prej 200 rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak, ku gjatë kësaj kërkuesi në vlerën e përlllogaritur të programit duhet të marrë pjesë me pjesëmarrje vetjake prej 20% (mjete vetjake, kredi nga banka ose mjete personale të pronarit të firmës), ndërsa shumica e mjeteve të ndara mund të jetë më së shumti deri në lartësinë e pronës dhe kapitalit të përhershëm të regjistruar në librat e kërkuesit (depozitimi bazë, pajisja, objektet ndërtimore dhe afariste, dyqanet e ngjashëm) dhe të depozitohet hipotekë në përpjesëtim 2:1 ose garanci bankare në lartësinë e mjeteve të lejuara. Hipoteka ose garancia bankare të jetë me vlefshmëri prej së paku 3 vjetësh.”

Pika 4 fshihet.

Në nenin 2 fjalët: “pikat 3 dhe 4”, zëvendësohen me fjalët: “pika 3”.

Paragrafi 3 ndryshon si vijon:

“Paraqitësi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete nga fondi i veçantë për dedikimet nga paragrafi 1 pika 1 e këtij neni, në kushtet e përcaktuara me Ligj, nëse është aktiv me punë, ka bonitet pozitiv që dëshmohet me dokumentin e lëshuar nga institucioni kompetent dhe rregullisht paguan rrogë për nëntë muajt e fundit, duke llogaritur nga dita e punësimit të personit invalid dhe depoziton hipotekë ose garanci bankare me afat të arritjes deri në 11 muaj, në lartësinë e mjeteve që i kërkon nga Fondi i veçantë për punësimin e personit invalid. Garancia bankare përkatësisht hipoteka do të aktivizohet nëse punëdhënësi e zvogëlon numrin e përgjithshëm të personave invalidë nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji ose nuk u paguan rrogë më tepër se 90 ditë.”

Paragrafi 4 zëvendësohet me dy paragrafë të rinj 4 dhe 5, si vijojnë:

“Me përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, nëse dorëzuesi i kërkesës nuk paraqet hipotekë ose garanci bankare në lartësinë e mjeteve që i kërkon nga Fondi i veçantë për punësim të personit invalid, do t’i paguhet 50% nga mjetet e lejuara, ndërsa mbetja do t’i paguhet në 10 muajt e ardhshëm në 10 këste të barabarta, obligimi për depozitim e hipotekës ose garancisë bankare nuk ka të bëjë me administratën shtetërore, njësitë e vetadministrimit lokal, ndërmarrjet publike, institucionet, agjencitë dhe fondet dhe institucionet tjera shtetërore.

Paraqitësi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete për dedikimet nga pika 3 e këtij neni nëse është aktiv me punë së paku 3 vjet.”

Në paragrafin 5 i cili bëhet paragraf 6 pas numrit 2, presja zëvendësohet me lidhëzën “dhe” ndërsa pas numrit 3 fjalët: “dhe 4” shlyhen.

Në paragrafin 6 i cili bëhet paragraf 7 numri “3” zëvendësohen me numrin “4”.

Neni 18

Në nenin 16-b në paragrafin 1 pas fjalës “persona” shtohen fjalët: “nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji”, fjala “e” zëvendësohet me fjalën “e”, ndërsa fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.

Paragrafi 3 ndryshon si vijon:

“Punëdhënësi mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për punësim të personit invalid të papunësuar nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji, nëse në evidencën e Agjencisë mbahet si person invalid i papunësuar. Për punësimin e personit invalid nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji për të cilin janë shfrytëzuar mjete për punësim nga Fondi i veçantë, gjatë punësimit të serishëm punëdhënësi i ri nuk mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për punësimin e personit invalid, para skadimit të pesë vjetëve, duke llogaritur nga dita e themelimit të marrëdhënies së re të punës.”

Në paragrafin 6 rreshti i parë pas fjalës “persona” shtohen fjalët: “nga neni 2 paragrafi 1 i këtij Ligji”,

Paragrafi 8 shlyhet.

Neni 19

Në nenin 18 paragrafin 1 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”.
Në paragrafin 2 fjalët: “Enti obligohet”, zëvendësohen me fjalët: “Agjencia obligohet”.

Neni 20

Në paragrafin 20-a, fjalët: “1, 7 dhe 8” zëvendësohen me fjalët: “1 dhe 7”.

Neni 21

Në nenin 22 numri “6” zëvendësohet me fjalët: “16-a, paragrafi 6”.

Neni 22

Në nenin 23 numri “6” zëvendësohet me fjalët: “16-a, paragrafi 6”.

Neni 23

Në nenin 24 fjala “Enti” zëvendësohet me fjalën “Agjencia”, ndërsa fjalët: “2 dhe 4”, zëvendësohen me fjalët: “5 dhe 7”.

Neni 24

Ministria e Punës dhe e Politikës sociale në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji do ta nxjerrë aktin nga neni 4 të këtij ligji.

Neni 25

Kërkesat e paraqitura për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë të cilat nuk janë zgjidhur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zgjidhen sipas dispozitave të ligjit që ka qenë në fuqi gjatë kohës së paraqitjes së kërkesës.

Neni 26

Mjetet nga neni 15 paragrafi 1 i këtij ligji do të ndahen duke filluar nga 1 janari i vitit 2007.

Neni 27

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjdhënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekstin e spastruar të Ligjit për punësimin e personave invalidë.

Neni 28

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.